

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shantazhi ndaj Klodiana Lalës/ Fevziu: Deklarata e Hysenit ngre pikëpyetje ligjore dhe etike - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/shantazhi-ndaj-klodiana-lales-fevziu-deklarata-e-hysenit-ngre-pikepyetj-e-ligjore-dhe-etike/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 18:11:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 18:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3a3e98dfb1b146efe54ed54fd566d7af3cddab8f11640acf62475ec2c24602e4
TEKSTI	7c7e3381b44aefbb2392412a7e8a326551c425d9fdb58f5ec73b624e7d41e48
PAMJA	b0c508487f2d77593eb51ecb11383e59b246dd2fe16e60b78c44c117ad2545f0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	23703bc31ed85d0468b385bd4c1ab6511fddd93087949d220133b6f70b66755c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1385e7008e03de6abe2f8860ad6394539cccd8b72b1ba567a2f7f8b6825304
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/23703bc31ed85d0468b385bd4c1ab6511fddd93087949d220133b6f70b66755c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Shantazhi ndaj Klodiana Lalës/ Fevziu: Deklarata e Hysenit ngre pikëpyetje ligjore dhe etike

AKTUALITET

Demo

Shantazhi ndaj Klodiana Lalës/ Fevziu: Deklarata e Hysenit ngre pikëpyetje ligjore dhe etike

SEPTEMBER 24, 2026



Gazetari Blendi Fevziu ka reaguar lidhur me deklaratën e ish-drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni, ndaj gazetares Klodiana Lala, në një moment kur kjo e fundit po raportonte për paraqitjen e Hysenit në SPAK.

Përmes një reagimi, Fevziu e cilëson situatën si problematike dhe ngre pikëpyetje si në aspektin ligjor, ashtu edhe në atë etik, lidhur me mënyrën se si ish-drejtoresha e shërbimit inteligjent iu përgjigj raportimeve të gazetares.

Sipas Fevziut, përplasja lidhet me raportimet e fundit të Klodiana Lalës, e cila ka bërë publike pretendime të rënda në lidhje me veprimtarinë e Hysenit. Në përgjigje, ish-drejtoresha e SHISH ka bërë një pretendim në drejtim të gazetares.

Fevziu argumenton se, pavarësisht peshës së një akuze, përgjigja ndaj saj nuk mund të jetë domosdoshmërisht një kundërakuzë, veçanërisht kur në deklaratë përmenden pretendime që lidhen me mënyrën e funksionimit të një shërbimi inteligjent.

Gazetari ngre edhe pyetjen se çfarë e ka shtyrë Hysenin të bëjë një deklaratë të tillë dhe, nëse pretendimi i saj do të rezultonte i vërtetë, çfarë pasojash do të kishte kjo për mënyrën se si funksionojnë operacionet e një shërbimi sekret.

Reagimi i Fevziut vjen në kontekstin e raportimeve të mëparshme të Klodiana Lalës, e cila ka deklaruar se ish-drejtoresha e SHISH ka përgjuar zyrtarë të lartë.

Në reagimin e tij, Fevziu përmend edhe mundësinë që ndër personat e pretenduar si të përgjuar të ketë qenë ish-ministri i Brendshëm dhe kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla.

Deklaratat e bëra nga të dyja palët përbëjnë pretendime publike dhe mbeten për t'u vlerësuar në bazë të fakteve dhe verifikimeve përkatëse.

Reagimi i gazetarit Blendi Fevziu:

Sot, ish-shefja e Shërbimit Sekret Shqiptar, Vlora Hyseni, që ishte thirrur për t'u marrë në pyetje, kërcënoi në mënyrë të çuditshme gazetaren Klodiana Lala, ndërsa ishte duke hyrë brenda ambienteve të SPAK. Pyetjes mbi aktivitetin e saj kriminal, ajo iu përgjigj me një kundërpjetje: Klodi, si kalon ti në takimet me agjentët serbë në dhomat e hotel Rognerit. Padyshim që deklarata e saj nuk qëndron dhe për këtë janë shprehur shumë vetë, por pyetja ime e parë është: Përse e bëri këtë Vlora Hyseni?

Në radhë të parë, ajo ka bërë një skandal, duke shkelur dy herë ligjin. Në rast se kjo gjë do të ishte e vërtetë dhe shefja e SHISH-it ishte në dijeni, ajo ka dekonspiruar një operacion të fshehtë, në të cilin SHISH po ndjek një gazetare. Është një shkelje ligjore, përveç shkeljes së etikës. Por, padyshim që kjo nuk është e vërtetë.

Postimet e reja

Radar Media Group në mbështetje të gazetares...

SEPTEMBER 24, 2026

"Çmimet do të rriten edhe më shumë"/ Harizi zbulu...

SEPTEMBER 24, 2026

Shantazhi ndaj Klodiana Lalës/ Fevziu: Deklarata ...

SEPTEMBER 24, 2026

Çfarë strategjie mund të ndjekë Kosova për apeli...

SEPTEMBER 24, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç 'Delvina Gas' ai...

ALERT në Sloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë përmbajtje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

Në rastin e dytë, pra në rast se e ka sajuar këtë gjë për t'u hakmarrë ndaj Klodiana Lalës, apo për të hërhequr vëmendjen nga lajmet e fokusuara tek ajo, është një gabim po kaq i rëndë dhe përbën sërish vepër penale.

Por përse Vlora Hyseni kërcënoi Klodiana Lalën?

Dy ditë më parë, Lala akuzoi Hysenin, mbi bazë dokumentesh që sipas saj i kishte konsultuar me materialet e SPAK-ut, se Hyseni ka përgjuar deputetë të rëndësishëm, duke përfshirë edhe ish-ministrin e Brendshëm dhe kryetarin e Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla.

A e ka përgjuar SHISH Taulant Ballën për llogari të Ergys Agasit? Kjo është e vështirë të vërtetohet në këtë moment, por padyshim është një akuzë e rëndë e bërë nga gazetarja në drejtim të ish-shefes dhe akuza nuk mund të mbulohet kurrë me kundërakuza.

Fevziu Hyseni Lalës

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radar.lajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.